

Njoftim

Për zhvillimin e testimit për vlerësues dëmsh në sigurime

Në zbatim të nenit 227 pika 3, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe nenit 7, të Rregullores nr.35, datë 27.03.2019, “Mbi organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencë/rinovim licence në AMF”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, njofton të gjithë të interesuarit, se:

Më datë 16 dhjetor 2024 do të zhvillohet testimi për rinovim të licencës së vlerësuesve të dëmeve në sigurime.

Në testim do të marrin pjesë ata aplikantë, që plotësojnë të gjitha kërkesat e Ligjit nr. 52 datë 22.05.2014, si dhe të Rregullores nr. 85, datë 03.07.2017, “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e ndryshuar.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 13 të Rregullores nr. 35, datë 27.03.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencë/rinovim licence në AMF”, në testim do të marrin pjesë edhe ata aplikantë për rinovim licence, që kanë marrë vlerësim negativ në testimet pararendëse.

Për detaje lidhur me zhvillimin e testeve, aplikantët që plotësojnë kërkesat ligjore do të njoftohen paraprakisht, sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren nr. 35, datë 27.03.2019.

Për më tepër informacion kontaktoni amf@amf.gov.al.